



# Anuluesit e Islamit

Autor: Shejkhul-Islam Muhamed Ibn 'Abdul-Uehab



Shpjeguar nga Shejkh Ahmed Jahja en-Nexhmij

**SELEFI**  
Kurani dhe Suneti **ORG**  
sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti





## Përmbajtja:

Anuluesi i Parë .....	fq. 3
Anuluesi i Dytë .....	fq. 8
Anuluesi i Tretë .....	fq. 11
Anuluesi i Katërt .....	fq. 13
Anuluesi i Pestë .....	fq. 15
Anuluesi i Gjashtë .....	fq. 16
Anuluesi i Shtatë .....	fq. 18
Anuluesi i Tetë .....	fq. 25
Anuluesi i Nëntë .....	fq. 27
Anuluesi i Dhjetë .....	fq. 29
Përfundim .....	fq. 31



## ANULUESI I PARË:

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti.

Dije se anuluesit e Islamit janë dhjetë.

**¶ pari është:** Shirku, të bërit shok Allahut të Lartësuar në adhurimin e Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ

“Vërtet Allahu nuk fal t’i bëhet shok Atij në adhurim dhe i fal gjynahet e tjera veç kësaj atij që dëshiron Ai.”<sup>1</sup>

Dhe ka thënë i Lartësuari:

إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ

مِنْ أَنْصَارٍ

<sup>1</sup> En-Nisa, 116.

“Vërtet ai që i bën shok Allahut në adhurim atëherë Xheneti do të jetë haram për të dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri. Dhe për zullumqarët nuk do të ketë asnjë ndihmues (në Zjarr).”<sup>2</sup>

Dhe tek shirku hyn therja e kurbaneve për dikë tjetër veç Allahut, si për shembull ai që ther kurban për ndonjë Xhin apo për ndonjë varr.

## SHPJEGIMI:

Vërtet, prej librave dhe shkrimeve të Shejkhul-Islam (Muhamed Ibn’Abdul-Uehab) është edhe “Dhjetë Anuluesit e Islamit”; dhe ajo që ka detyrë Muslimani është që të sigurohet që t’i mësojë këta anulues derisa të mos bjerë në ta pa e kuptuar.

Dhe anuluesi i parë e më i madhi është të bërit shirk Allahut ‘*Azaze ue Xhel*’ dhe argumentet për këtë janë të shumta. Prej tyre është thënia e Allahut ‘*Azaze ue Xhel*’.

اللَّهُ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ

“Vërtet Allahu nuk fal t’i bëhet shok Atij në adhurim dhe i fal gjynahet e tjera veç kësaj atij që dëshiron Ai.”<sup>3</sup>

E prej tyre është thënia e Tij ‘*Azaze ue Xhel*’ duke treguar për Isain (‘*alejhis-selam*’) se ai tha:

إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ

مِنْ أَنْصَارٍ

<sup>2</sup> El-Ma’ideh, 72.

<sup>3</sup> En-Nisa, 116.

“V̄ertet ai q̄e i b̄en shok Allahut n̄e adhurim at̄her̄e Xheneti do t̄e jet̄e harram p̄er t̄e dhe vendbanimi i tij do t̄e jet̄e Zjarri. Dhe p̄er zullumqar̄et nuk do t̄e ket̄e asnj̄e ndihmues (n̄e Zjarr).”<sup>4</sup>

E prej tyre ̄sht̄e th̄enia e Tij *Subhanehu ue Te’ala*:

وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ ۚ

إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ ﴿١١٧﴾

“Ai q̄e krahas Allahut i lutet t̄e adhuruarve t̄e tjer̄e, duke mos pasur kurrfar̄e argumenti p̄er ket̄e, at̄her̄e s’ka dyshim se ai e ka llogarin̄e tek Zoti i tij. Me t̄e v̄ertet̄e, nuk ka shp̄etim p̄er mohuesit.”<sup>5</sup>

si dhe ajete t̄e tjera q̄e tregojn̄e se mushrikut nuk i pranohet vepra e mir̄e dhe nuk i falen gjynahet, madje edhe n̄ese ka qen̄e nga njer̄ezit m̄e t̄e af̄ert tek Allahut ‘*Az̄ze ue Xhel*, nga njer̄ezit m̄e t̄e m̄edhenj e me pozit̄e t̄e lart̄e tek Ai.

Dhe ka th̄en̄e Ai *Subhanehu ue Te’ala*:

وَلَقَدْ أُوحِيَ إِلَيْكَ وَإِلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكَ لَئِن أَشْرَكَتَ لَيَحْبَطَنَّ عَمَلُكَ

وَلَتَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٦٥﴾

“Me t̄e v̄ertet̄e, tashm̄e t̄e ̄sht̄e shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre q̄e kan̄e qen̄e para teje: N̄ese i shoq̄eron Allahut diq̄ka tjet̄er (n̄e adhurim), me siguri q̄e pun̄et e tua do t̄e zhvler̄esohen dhe do t̄e jesh nd̄er t̄e humburit.”<sup>6</sup>

<sup>4</sup> El-Ma’ideh, 72.

<sup>5</sup> El-Mu’minun, 117.

<sup>6</sup> Ez-Zumer, 65.

Dhe ka thënë për Pejgamberët në suren el-En'am, pasi që përmend disa prej tyre:

ذَلِكَ هُدَى اللَّهِ يَهْدِي بِهِ مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ ۗ وَلَوْ أَشْرَكُوا لَحَبِطَ عَنْهُمْ  
مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٨٨﴾

“Ky është udhëzimi i Allahut, të cilin Ai ia jep kujt të dojë nga robërit e Vet. Por, sikur ata t’i kishin bërë shirk Allahut, do t’u humbiste çdo gjë nga ajo që kanë bërë.”<sup>7</sup>

Dhe nga Ebij Hurejrah (*radij-Allahu ‘anhu*) i cili ka thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*): *Tha Allahu Tebarake ue Te’ala*:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ اللَّهُ تَبَارَكَ وَتَعَالَى أَنَا أَغْنَى الشُّرَكَاءِ عَنِ الشُّرْكِ مَنْ  
عَمِلَ عَمَلًا أَشْرَكَ فِيهِ مَعِيَ غَيْرِي تَرَكَهُ وَشِرْكُهُ.

“Unë jam më i panevojshmi për ortak; kush bën një vepër duke më shoquar të tjerë në të, e kam braktisur atë dhe ortakun që më shoqëroi.”<sup>8</sup>

Pra, të gjitha këto argumente tregojnë se kush i bëri Allahut shirk të madh, duke iu lutur dikujt tjetër në vend të Allahut që t’i sjellë dobi e t’i largojë dëmin – **duke besuar në fuqinë e tij për ta bërë atë gjë** – atëherë ai ka dalë nga Islami. Dhe prej atyre veprave është edhe therja e kurbanit për të tjerë në vend të Allahut ‘*Azze ue Xhel*, ngase Allahu *Subhanehu ue Te’ala* i thotë Pejgamberit të Tij:

<sup>7</sup> El-En'am, 88.

<sup>8</sup> Transmetuar nga Muslimi, n2989.

قُلْ إِنِّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٦٢﴾ لَا شَرِيكَ لَهُ ۗ وَبِذَلِكَ  
أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُسْلِمِينَ ﴿١٦٣﴾

“Thuaj: “N  t  v rtet , namazi im, kurban i im, jeta ime dhe vdekja ime, i p rkasin vet m Allahut, Zotit t  bot ve. Ai nuk ka asnj  ortak. K shtu jam urdh ruar dhe un  jam i pari q  i n nshtrohem Atij”.”<sup>9</sup>

Andaj kush ther kurban p r xhinin apo p r varrin, at her  ai ka b r  shirk t  madh dhe klasifikohet si kuf r n  Nj shm rin  e Allahut ‘*Az ze ue Xhel*, kuf r q  e nxjerr at  nga Islami.



<sup>9</sup> El-En’am, 162-163.

## ANULUESI I DYTË:

**¶ dyti:** kush vendos mes tij dhe Allahut ndërmjetësa të cilëve u lutet, u kërkon dhe u mbeshtetet, ky ka bërë kufër sipas Ixhmasë.

### SHPJEGIMI:

Argumentet për këtë anulues janë të njëjta me argumentet e anuluesit të parë. Kështu që ky konsiderohet prej llojeve të Shirkut. Mushrikët tek të cilët u dërgua i Dërguari i Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) besonin në njëshmërinë e Allahut në Rububijeh dhe se Ai nuk kishte asnjë ortak në krijimin e krijesave, në furnizimin e tyre dhe në vdekjen e tyre. Mirëpo ata adhuronin të adhuruarit e tyre me pretendimin se ata ishin ndërmjetësa mes tyre dhe Allahut dhe kërkonin të ndërmjetësonin për ta.

Dhe për këtë shkak ka ardhur në ajete të shumta njoftimi i mushrikëve se ajo që bënin ishte gabim i turpshëm dhe mohim i fuqisë së Allahut *'Azzze ue Xhel*, dijes së Tij gjithëpërfshirëse dhe sundimit të Tij absolut, ndonëse ata besonin se Allahu është Krijuesi dhe se të adhuruarit të cilëve u luteshin nuk krijonin asgjë prej gjëje dhe as nuk posedonin gjë prej gjëje, as për vetet e tyre e as për ta. Dhe prej atyre ajeteve është thënia e Allahut *'Azzze ue Xhel* pasi që përmend diçka prej cilësive të Tij dhe përsosmërisë së Tij në suren Fatir.

Pastaj Ai ka thënë:

يُولِجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَيُولِجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ كُلًّا يَجْرِي لِأَجَلٍ مُّسَمًّى ۚ ذَٰلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ لَهُ الْمُلْكُ ۚ وَالَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ مَا يَمْلِكُونَ مِنْ قِطْمِيرٍ ﴿١٣﴾ إِنَّ تَدْعُوهُمْ لَا يَسْمَعُونَ دُعَاءَكُمْ وَلَوْ سَمِعُوا مَا اسْتَجَابُوا لَكُمْ ۗ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكْفُرُونَ بِشِرْكِكُمْ ۗ وَلَا يُنَبِّئُكَ مِثْلُ خَبِيرٍ ﴿١٤﴾



“Ai e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën të kalojë në natë. Ai i ka nënshtruar Diellin dhe Hënën, kështu që secili lëviz për një kohë të caktuar. Ky është Allahu, Zoti juaj. Pushteti është i Tij! Kurse ata që ju i adhuroni krahas Tij nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshtëm.”<sup>10</sup>

Dhe ka thënë në suren Furkan:

وَأَتَّخِذُوا مِنْ دُونِهِ ءَالِهَةً لَّا تَخْلُقُونَ شَيْئًا وَهُمْ يُخْلَقُونَ وَلَا يَمْلِكُونَ لِأَنْفُسِهِمْ  
ضَرًّا وَلَا نَفْعًا وَلَا يَمْلِكُونَ مَوْتًا وَلَا حَيَاةً وَلَا نُشُورًا ﴿٢٢﴾

“E megjithatë ata adhurojnë në vend të Tij zota (të adhuruar), të cilët nuk krijojnë asgjë e që vetë janë të krijuar, që nuk zotërojnë për veten as dëm e as dobi, e që nuk janë në gjendje të japin as vdekjen, as jetën e as që të ringjallin.”<sup>11</sup>

Dhe ka thënë në suren Seb`e:

قُلِ ادْعُوا الَّذِينَ زَعَمْتُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَا يَمْلِكُونَ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ فِي السَّمَوَاتِ وَلَا  
فِي الْأَرْضِ وَمَا هُمْ فِيهِمَا مِنْ شَرِكٍ وَمَا لَهُ مِنْهُمْ مِنْ ظَهِيرٍ ﴿٢٢﴾

“Thuaju (o Muhamed): “Thirrini ata që i hyznizoni krahas Allahut! Ata nuk kanë pushtet as sa pesha e një thërrmije, qoftë në qiej apo në Tokë; për ata nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë dhe Allahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre.”<sup>12</sup>

<sup>10</sup> Fatir, 13-14.

<sup>11</sup> El-Furkan, 3.

<sup>12</sup> Seb`e, 22.

Si dhe ajete të tjera të ngjashme.

Madje na ka njoftuar Allahu *Subhanehu ue Te'ala* në suren Zumer se ata thanë:

مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ  
تَخْتَلِفُونَ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَاذِبٌ كَفَّارٌ ﴿٣٠﴾

““Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu”, Allahu me siguri që do t’i gjykojë për mospajtimet që kanë patur. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar e mohues.”<sup>13</sup>

Dhe ajetet për këtë janë të shumta. E rëndësishme është se ata të cilët pos Allahut marrin ndërmjetësa që t’u kërkojnë ndërmjetësim dhe u luten e u mbështeten në vend të Allahut, atëherë duke u nisur nga kjo ata konsiderohen mosbesimtarë (kufarë), sikurse përfundon edhe ajeti i sures Zumer.



<sup>13</sup> Ez-Zumer, 3.

## ANULUESI I TRETË:

**Ti treti:** Kush nuk i bën qafira mushrikët, ose dyshon në kufrin e tyre ose e konsideron të saktë rrugën e tyre, ka bërë kufër.

### SHPJEGIMI:

Me të vërtetë Allahu *Subhanehu ue Te'ala* i ka quajtur mushrikët (idhujtarët) qafira (kufarë) në më shumë se një ajet; dhe prej tyre:

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا  
أُولَئِكَ هُمْ شَرُّ الْبَرِيَّةِ ﴿٦﴾

“Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej Ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.”<sup>14</sup>

Pra, në këtë ajet Allahu i ka bërë bashkë Ithtarët e Librit dhe mushrikët dhe bën të qartë se me të vërtetë ata janë mosbesimtarë (kufarë) dhe se vendbanimi i tyre do të jetë Xhehenemi.

Dhe ka thënë për mushrikët duke i përmendur ata veçmas:

زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ  
وَذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٧﴾

“Pretenduan ata të cilët nuk besojnë se nuk do të ringjallen. Thuaju: “Po, pasha Zotin tim, sigurisht që do të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë ç’keni bërë!” Dhe kjo është e lehtë për Allahun.”<sup>15</sup>

<sup>14</sup> El-Bejjineh, 6.

Dhe ka thënë për Çifutët:

فَبِظُلْمٍ مِّنَ الَّذِينَ هَادُوا حَرَّمْنَا عَلَيْهِمْ طَيِّبَاتٍ أُحِلَّتْ لَهُمْ وَبِصَدِّهِمْ عَنِ سَبِيلِ اللَّهِ كَثِيرًا  
وَآخَذِهِمُ الرِّبَا وَقَدْ هُمُ الرِّبَاؤُا وَقَدْ هُمُ الرِّبَاؤُا وَقَدْ هُمُ الرِّبَاؤُا وَقَدْ هُمُ الرِّبَاؤُا وَقَدْ هُمُ الرِّبَاؤُا  
مِّنْهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا

“Për shkak të padrejtësive të jehudive, Ne i bëmë të palejuara për ta disa ushqime të mira të cilat kanë qenë të lejuara për ta dhe për shkak se ndalonin shumë njerëz të ndjekin Rrugën e Allahut; dhe për shkak të marrjes së kamatës nga ana e tyre, megjithëse e kishin të ndaluar që ta marrin atë dhe për shkak të marrjes pa të drejtë dhe gllabërimit të pasurisë së tjetrit. Dhe kështu Ne kemi përgatitur dënim të dhimbshëm për mosbesimtarët.”<sup>16</sup>

Dhe ka thënë për Kristianët:

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ

“Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: “Allahu është Mesihu, i biri i Merjemes!”<sup>17</sup>

si dhe mjaft ajete të tjera.

Dhe kush nuk i bën qafira ata mosbesimtarë, atëherë ai mohon lajmin e Allahut ‘*Azxe ue Xhel* që na njofton se ata janë me të vërtetë mosbesimtarë dhe për këtë shkak edhe ai konsiderohet mosbesimtar.



<sup>15</sup> Et-Tegabun, 7.

<sup>16</sup> En-Nisa, 160-161.

<sup>17</sup> El-Ma`ideh, 72.



## ANULUESI I KATËRT:

**¶ katërti:** Kush beson se ka udhëzim më të përsosur se ai i Pejgamberit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*), apo se gjykimi i të tjerëve është më i mirë se gjykimi i tij, si ai që preferon gjykimin e Tagutëve në vend të gjykimin të tij, atëherë ky person është mosbesimtar (kafir).

### SHPJEGIMI:

Prej kërkesave të besimit në Mesazhin e Muhamedit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) është të besuarit se udhëzimi i tij është më i përsosuri dhe se gjykimi i tij është më i miri.

Ka thënë i Lartësuar:

وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِقَوْمٍ يُوقِنُونَ ﴿٥٠﴾

“E kush është gjykatës më i mirë se Allahu për njerëzit që besojnë bindshëm?”<sup>18</sup>

Pyetja në këtë ajet është pyetje qortuese, që do të thotë: në të vërtetë nuk ka gjykim më të mirë sesa gjykimi i Allahut të Lartësuar.

Dhe vërtet, thoshte Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) në fillim të hytbes së tij:

و أحسن هدي هدي محمد .

“Dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit.”<sup>19</sup>

<sup>18</sup> El-Ma`ideh, 50.

<sup>19</sup> Transmetuar nga Bukhari (n.6098) nga ‘Abdullah Ibn Mes’udi (*radij-Allahu ‘anhu*) në formë *meukuf*.

Nëse udhëzimi më i mirë është udhëzimi i tij (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), atëherë kjo e bën të domosdoshëm tek kjo gjë, d.m.th. që rob i të besojë se udhëzimi më i mirë është udhëzimi i tij (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), dhe kush nuk e beson këtë, përkundrazi, beson se udhëzimi i të tjerëve është më i mirë sesa udhëzimi i tij ose gjykimi i të tjerëve është më i mirë sesa gjykimi i tij, atëherë në këtë rast ai njeri ka mohuar shpalljen me të cilën erdhi ai (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*).

Pra, ata të cilët preferojnë gjykimin e Tagutëve para gjykimit të tij konsiderohen mosbesimtarë për këtë arsye.



## ANULUESI I PESTË:

**¶ pesti:** Kush urren diçka prej asaj me të cilën erdhi i Dërguari (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) edhe nëse e punon atë, ai ka mohuar.

### SHPJEGIMI:

Pra, të urreyerit e dispozitave dhe ligjeve me të cilat erdhi i Dërguari (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) konsiderohet kufër (mosbesim). Dhe detyra jonë është që ta duam atë (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe të duam çdo gjë me të cilën erdhi ai, si dhe të besojmë se çdo gjykim me të cilin ka ardhur ai është gjykimi më i mirë; edhe nëse është moral ai është morali më i mirë, edhe nëse është ibadet ai është ibadeti më i mirë.

Kështu që, të urresh atë me të cilën erdhi ai apo diçka prej saj, atëherë ky është argument i nifakut (hipokrizisë) – Allahu na ruajt! Dhe kush e gjen këtë cilësi në veten e tij, atëherë ai duhet të punojë me veten e tij që ta largojë atë dhe t'i lutet Allahut '*Azxe ue Xhel* që ta pastrojë nga ajo dhe ta zëvendësojë urrejtjen me dashuri, përbuzjen me madhërim dhe neverinë me dëshirë të zjarrtë për të.



## ANULUESI I GJASHTË:

**¶ gjashti:** Kush tallet me diçka prej Fesë së të Dërguarit apo me shpërblimin e Allahut dhe ndëshkimin e Tij ka mohuar. Dhe argument është thënia e të Lartësuarit:

قُلْ أَبِاللَّهِ وَءَايَاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ ﴿١٥﴾ لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ

“Thuaju: A me Allahun, me Ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleni? Mos u shfajësoni, ju keni mohuar pasiqë besuat.”<sup>20</sup>

### SHPJEGIMI:

Pra, të tallurit me Fenë e të Dërguarit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) apo me shpërblimin dhe dënimin në Islam është kufër. Dhe kush tallet me mjekrrën apo tallet me diçka prej dispozitave të Fesë, atëherë ai konsiderohet se ka bërë kufër dhe ka dalë nga Islami.

Dhe ka ardhur në hadith se disa munafikë thanë kur ishin duke shkuar për në Tebuk: “Nuk kemi parë njerëz më të babëzitur me barqet e tyre, më gënjeshtarë me gjuhët e tyre e më frikacakë në fushëbetejë sesa këta kënduesit tanë të Kur'anit.” Ata kishin për qëllim të Dërguarin e Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe Shokët e tij që këndonin Kur'anin.

Atëherë zbriti Allahu këto ajete:

وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ لَيَقُولُنَّ إِنَّمَا كُنَّا نَخُوضُ وَنَلْعَبُ قُلْ أَبِاللَّهِ وَءَايَاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ  
تَسْتَهْزِئُونَ ﴿١٥﴾ لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ

<sup>20</sup> Et-Teube, 65-66.



“Dhe nëse i pyet, ata do të thonë: “Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim”. Thuaj: A mos vallë me Allahun, shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?” Mos u shfajësoni! Ju keni mohuar, pasi patët besuar.”<sup>21</sup>

Mirëpo, me të vërtetë po dëgjojmë prej njerëzve të kohës së sotme fjalë të ngjashme me këto apo më të rënda dhe ata as që duan t’ia dijnë.

Allahu na dhëntë shëndet e mirëqenie.



---

<sup>21</sup> Et-Teube, 65-66.

## ANULUESI I SHTATË:

**¶ shtati:** Magjia, prej së cilës është edhe ajo që i shkakton njeriut të urrejë një person (*sarf*) ose ta dojë atë (*'atf*). Dhe kush e bën atë ose është i kënaqur me të ka bërë kufër. Dhe argument është fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ<sup>ط</sup>

“Por asnjëri prej këtyre dyve (dy melekët, Haruti dhe Maruti) nuk ia mësuar dikujt (magjinë) derisa t’u kenë thënë më përpara: Vërtet, ne jemi një sprovë; kështu që mos mohoni.”<sup>22</sup>

### SHPJEGIMI:

Me të vërtetë na ka njoftuar Allahu *Subhanehu ue Te’ala* se mësimi i magjisë është kufër dhe detyrimisht edhe bërja e magjisë është kufër.

Allahu *Subhanehu ue Te’ala* thotë:

وَاتَّبِعُوا مَا تَتْلُوا الشَّيْطِينُ عَلَىٰ مُلْكٍ سُلَيْمٍ وَمَا كَفَرَ سُلَيْمٌ وَلَكِنَّ الشَّيْطِينَ  
كَفَرُوا يَعْلَمُونَ النَّاسَ السِّحْرَ وَمَا أُنزِلَ عَلَى الْمَلَكَيْنِ بِبَابِلَ هِرُوتَ وَمُرُوتَ وَمَا  
يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ<sup>ط</sup> فَيَتَعَلَّمُونَ مِنْهُمَا مَا يُفَرِّقُونَ  
بِهِ بَيْنَ الْمَرْءِ وَزَوْجِهِ<sup>ع</sup> وَمَا هُمْ بِضَارِينَ بِهِ<sup>ه</sup> مِنْ أَحَدٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ وَيَتَعَلَّمُونَ مَا يَضُرُّهُمْ

<sup>22</sup> El-Bekareh, 102.

وَلَا يَنْفَعُهُمْ ۚ وَلَقَدْ عَلِمُوا لَمَنِ اشْتَرَاهُ مَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلْقٍ وَلَبِئْسَ مَا شَرَوْا  
بِهِ أَنْفُسَهُمْ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿١٢﴾

“Dhe ata shkuan pas shpifjeve që bënëin djajtë kundër mbretërisë së Sulejmanit. E Sulejmani nuk ishte mohues, por djajtë ishin mohues. Ata u mësonin njerëzve magjinë dhe dijeninë që u ishte dërguar dy engjëjve në Babiloni - Harutit e Marutit. Këta engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: “Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!” Dhe njerëzit mësuan nga këta të dy se si t’i ndajnë bashkëshortët. Por magjistarët nuk mund t’i bëjnë dëm askujt pa lejen e Allahut. E megjithatë, njerëzit mësojnë ato gjëra që i dëmtojnë e nuk u bëjnë dobi. Në të vërtetë, ata e dinin se ai që e përvetësonte këtë mjeshtëri, nuk do të kishte kurrfarë të mire në jetën tjetër. Eh, sa e keqe është ajo për të cilën i shitën shpirtrat e veta! Ah, sikur ta dinin!”<sup>23</sup>.

Kuptimi i qartë i këtij ajeti është se mësimi i magjisë është kufër dhe punimi me të është kufër, për shkak të thënies së Tij:

وَمَا كَفَرَ سُلَيْمَانُ وَلَكِنَّ الشَّيَاطِينَ كَفَرُوا يُعَلِّمُونَ النَّاسَ السِّحْرَ

“E Sulejmani nuk ishte mohues, por djajtë ishin mohues. Ata u mësonin njerëzve magjinë.”<sup>24</sup>

Pra, kjo tregon se t’u mësosh njerëzve magjinë konsiderohet kufër.

Dhe ka thënë:

وَمَا أَنْزَلَ عَلَى الْمَلَائِكَةِ بَابِلَ هَرُوتَ وَمَرْوَتَ ۚ وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا  
نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ ۗ

<sup>23</sup> El-Bekareh, 102.

<sup>24</sup> El-Bekareh, 102.

“...dhe dijeninë që u ishte dërguar dy engjëjve në Babiloni - Harutit e Marutit. Këta engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: “Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!””

Dhe kjo tregon se ta mësosh magjinë është kufër.

Dhe në fund të ajetit ka thënë i Lartësuar:

وَلَقَدْ عَلِمُوا لَمَنِ اشْتَرَاهُ مَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلْقٍ

“Në të vërtetë, ata e dinin se ai që e përvetësonte këtë mjeshtëri, nuk do të kishte kurrfarë të mire në jetën tjetër.”

Domethënë, në Botën Tjetër ai s’do të ketë asnjë përfitim, por ai do të jetë prej banorëve të Zjarrit, prej atyre që meritojnë Dënimin. Pra ky ajet pohon kufirin (mosbesimin) e atij që e mësoi magjinë dhe ua mësoi atë të tjerëve dhe punoi me të, qoftë ajo magji që i shkakton njeriut të urrejë një person (*sarf*) ose ta dojë atë (*atf*) apo çfarëdolloj magjie.

Dhe mendimi i shumicës së Ulemave është se magjia është kufër, me përjashtim të Shafiut, nga i cili është përcjellë se duhet bërë hetim për këtë çështje. Ai ka thënë: “I themi magjistarit, na i përshkruaj magjinë tënde.”<sup>25</sup>

Unë them se të bërit tekfir mbi magjistarin pa bërë hetim (mbi gjendjen e tij) është e vërteta për shkak të asaj që përmendet në ajet dhe nga ajo që është transmetuar se Hafsa (*radij-Allahu ‘anha*) kishte një robëreshë e cila i bëri magji dhe urdhëroi që të vritej.

Dhe në hadithin e Bexhales i cili ka thënë: “Urdhëroi ‘Umer Ibnul-Khattab (*radij-Allahu ‘anhu*) që të vritet çdo magjistar e magjistare.” Dhe tha: “Kështu, i vramë tre magjistarë.”

<sup>25</sup> Fjalët që ka thënë Imam Shafi’i janë: “*Sih*r (magji) është emër që përmbledh kuptime të ndryshme. Andaj i thuhet magjistarit: Na i përshkruaj magjinë tënde. E nëse magjia që ai bën ka fjalë që janë kufër i qartë, atij i kërkohet të pendohet nga ajo gjë. Atëherë ai ose pendohet ose vritet dhe i merret pasuria. E nëse ai nuk bën magji me fjalë të cilat janë kufër i njohur dhe me të cilën ai s’dëmton njeri, ai ndalohet nga ajo gjë, e nëse kthehet lëshohet.” *el-Umm*, (1/206).



Gjithashtu, transmetimet tregojn  – p rveq ajetit q  u p rmend m  par  – se magjin  nuk mund ta b j askush tjet r p rveq qafirit.

E prej atyre transmetimeve  sht  edhe ajo q  ka p rcjell  Ibn Kethiri n  tefsirin e tij nga A’ishah (*radij-Allahu ‘anha*) e cila ka th n : “M  erdhi n j grua nga fisi Deumetul-Xhendel, e cila k rkonte t  D rguarin e Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*), mbasi q  ai kishte vdekur. Ajo donte ta pyeste at  p r disa  shtje magjie n  t  cilat ishte futur por pa e vepruar at .”

I tha A’ishah (*radij-Allahu ‘anha*) ‘Urves: “O biri motr s sime, e pash  at  t  qante kur nuk e gjeti t  D rguarin e Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) q  t  sh rohej prej tij. Vazhdoi duke qar  gjer sa mu dhimbs. Pastaj tha: “Kam frik  se jam e shkat rruar. Kam patur n j burr  i cili m  la. Erdhi tek un  n j plak  t  cil s i qava hallin. Ajo tha: “N se b n at  q  do t  urdh roj, un  do ta b j at  q  t  vij  tek ty.” Kur ra nata, ajo erdhi me dy qen  t  zinj, pastaj ajo hipi n  nj ri prej tyre kurse un  hipa tek tjetri. Dhe nuk kaloi shum  derisa ndaluam n  Babil ku ishin dy burra t  varur nga k mb t e tyre kok posht . Ata than : “P rse keni ardhur k tu?”

Un  thash : “Q  t  m sojm  magjin !”

Ata than : “Me t  v rtet  ne jemi fitne, prandaj mos b j kuf r!” Kthehu mbrapa!”

Kurse un  kund rshtova dhe thash : “Jo!”

Ata than : “At her  shko tek ajo furra atje dhe urino n  t .”

Un  shkova por u tremba dhe nuk b ra gj . K shtu q  u ktheva tek ata.

Ata m  than : “A e b re?”

Un  thash : “Po!”

Ata than : “A pe gj ?”

Un  thash : “Nuk pash  gj !”

Ata than : “Mos e b j! Kthehu n  vendin t nd e mos b j kuf r!”

Por un  kisha d shir  dhe refuzova q  t  kthehesha. Pastaj ata than : “Shko tek ajo furra atje dhe urino n  t .”

Un  shkova por u tremba dhe u frik sova; pastaj u ktheva tek ata t  dy e u thash : “E b ra!”

Ata m  than : “E  far  pe?”

Thash : “Nuk pash  gj !”

Ata than : “G njeve! Mos e b j, kthehu n  vendin t nd dhe mos b j kuf r. Ti e ke n  dor   shtjen t nde!”

Por un  kisha d shira dhe refuzova.

Ata thanë: “Shko tek ajo furra atje dhe urino në të.”

Atëherë shkova atje dhe urinova. Befas pashë një kalorës me maskë prej hekuri i cili doli nga unë dhe shkoi drejt qiellit derisa u zhduk dhe nuk e pashë më. Pastaj shkova tek ata të dy dhe u thashë: “E bëra!”

Ata thanë: “E çfarë pe?”

Thashë: “Pashë një kalorës me maskë prej hekuri që doli nga unë dhe shkoi drejt qiellit derisa u zhduk e nuk e pashë më.”

Ata thanë: “Të vërtetën the! Ai ishte imani yt i cili doli prej teje. Ik tani!”

Pastaj i thashë gruas: “Pasha Allahun, unë nuk di asgjë dhe ata nuk më thanë ndonjë gjë.”

Ajo tha: “Posi, çdo gjë që dëshiron do të realizohet. Merre këtë grurë dhe mbille.”

Unë e mbolla dhe thashë, “Mbi!” dhe ai mbiu. Pastaj thashë, “Korru!” dhe u korr. Pastaj thashë, “Qërohu!” dhe u qërua. Pastaj i thashë, “Thahu!” dhe u tha. Pastaj i thashë, “Bluhu!” dhe u blua. Pastaj i thashë, “Bëhu bukë!” dhe u bë bukë. Nuk kishte gjë që e dëshiroja e të mos realizohej dhe më binte në dorë. Pastaj u pendova – pasha Allahun o nëna e Besimtarëve – nuk kam bërë gjë dhe nuk do ta bëj më kurrë atë gjë.”

Ka transmetuar gjithashtu Ibn Ebij Hatim nga er-Rrabij’ Ibn Sulejman, që është vazhdimi i asaj që u përmend, dhe shtoi pas fjalëve të saj, “Nuk kam bërë gjë dhe nuk do ta bëj më kurrë atë gjë.”

“Atëherë i pyeta Shokët e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*), shumë pak mbas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) – dhe atë kohë ata ishin të shumtë – çfarë dinin dhe çfarë mund t’i thonin asaj. Dhe të gjithë ata u druajtën dhe patën frikë t’i jepnin asaj fetva për diçka rreth të cilës nuk kishin dije, me përjashtim të Ibn ‘Abbasit apo të disave që ishin me të, i cili tha: “Sikur të dy prindërit e tu ose njëri prej tyre të jetë gjallë (do të mjaftonte).”

Dhe prej argumenteve që tregojnë se magjinë e bën vetëm qafiri është se Shejtanët kur futen tek personi të cilit i është bërë magji, thonë: “Neve na ka urdhëruar filani, prandaj s’mund të dalim dot prej tij.”

Dhe shejtanët kur i mësojnë magjistarit magjinë i vendosin atij kushte, si për shembull: të fusë Kur'anin në banjë, të urinojë mbi të dhe fusë në

këpucë, duke e bërë këtë për 40 ditë. Dhe të gjitha këto tregojnë se magjistari nuk mund të bëjë dot magji veçse pasi që të ketë bërë kufër.

Dhe këtu ne themi se me të vërtetë magjia është e gjitha kufër dhe obligohet vrasja e magjistarit si masë ndëshkimore. Dhe është e qartë se ky ndëshkim duhet të kryhet edhe nëqoftëse ai shfaqet si i penduar. Kjo duke patur parasysh se magjistarët ndahen në dy kategori:

1 – [*Sibr Te`thjir*] Magjia që ndikon në gjendjen shpirtërore e mendore të personit.

2 – [*Sibr Tekhjii*] Magjia iluzioniste.

Lloji i parë [*Sibr Te`thjir*], është ajo magji që e bën personin të cilit i është bërë magji t'i shfaqen pamje apo gjëra. Ai preket nga ky fenomen derisa nuk gjen dot derman. E ndoshta kalojnë vite me rradhë e ai nuk e ka provuar shijen e rehatisë, qetësisë, dhe as mirësinë e logjikës së shëndoshë. E nëse ai shkon në spital dhe bën analizat mjekësore, si përfundim do t'i thonë se ai nuk ka asgjë!

Rreth kësaj është transmetuar se Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) i bënë magji. Transmetohet nga A'ishah (*radij-Allahu 'anha*) se ka thënë: "Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) i bënë magji, aq sa atij i dukej sikur bënte diçka, por në të vërtetë nuk e kishte bërë. Derisa po atë ditë në të cilën ishte tek unë, iu lut e iu lut Allahut, pastaj tha: "A e di o j A'isheh që Allahu më tregoi për atë që i kërkova?" Unë i thashë: "E çfarë është ajo o i Dërguari i Allahut?" Tha: "Më erdhën dy veta, e njëri prej tyre u ul pranë kokës sime, kurse tjetri u ul pranë këmbëve të mia. Pastaj njëri prej tyre i tha tjetrit: "Cili është shkaku i dhimbjeve të këtij njeriu?"

Ai tha: "I kanë bërë magji."

Ai e pyeti: "Kush i ka bërë magji?"

Ai tha: "Lebijd Ibnul-E'asam el-Jehudi, nga fisi Beni Zurajk."

Ai e pyeti: "Me çfarë?"

Ai tha: "Me një krëhër dhe flokët e mbetur në të, të vendosura në sythin e tharë të një palme të gjinisë mashkullore."

Ai pyeti: "E ku gjenden?"

Ai tha: "Në pusin Dhij Eruan."

Pastaj ajo (A'ishah) tha: “Atëherë Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) shkoi me disa nga shokët e tij tek pusi dhe pa në të dhe sipër tij”

Pastaj ai u kthye tek A'isheja dhe i tha: “Pasha Allahun oj A'isheh, uji i tij ishte i verdhë sikur kënjaja, dhe palmat e tij si koka shejtanësh.”

Unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, a e nxorre atë (magjinë)?”

Ai tha: “Jo, mua më pastroi e më shëroi Allahu, mirëpo pata frikë mos ajo i prekte Muslimanët.”<sup>26</sup>

Kurse magjia iluzioniste [*Sibr et-Tekhyil*] është ajo që ka përmendur Allahu ‘*Azze ue Xhel* rreth magjisë së atyre që ishin me Faraonin.

Ka thënë Allahu, Folësi më Fisnik:

﴿فَلَمَّا الْقَوْأَ سَحَرُوا أَعْيُنَ النَّاسِ وَأَسْتَرْهَبُوهُمْ وَجَاءُوا بِسِحْرٍ عَظِيمٍ﴾

“Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan dhe shfaqën një magji të madhe.”<sup>27</sup>

Dhe ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿قَالَ بَلْ أَلْقَوْا فَأِذَا حِبَاهُمْ وَعَصِيهِمْ تُخِيلُ إِلَيْهِ مِنْ سِحْرِهِمْ أَنَّهُ تَسْعَى﴾

“Ai tha: “Jo, hidhni ju!” Dhe ja tek i dukeshin atij litarët dhe shkopinjtë e tyre se po rendnin vërtet, për shkak të magjisë së tyre.”<sup>28</sup>



<sup>26</sup> Transmetuar nga Bukhari (n. 5766) dhe Muslimi (n. 2189).

<sup>27</sup> El-A'raf, 116.

<sup>28</sup> Ta-Ha, 66.



## ANULUESI I TETË:

**¶ teti:** Të ndihmohet e të përkrahësh Mushrikët kundër Muslimanëve. Dhe argumenti është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ وَالنَّصَرَىٰ أَوْلِيَاءَ ۚ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ ۚ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنكُمْ فَإِنَّهُ مِنَّهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٢١﴾﴾

“Dhe kushdo prej jush që i bën ata miq, atëherë ai është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë popullin zullumqar.”<sup>29</sup>

### SHPJEGIMI:

Ai që i ndihmon Mushrikët, Qafirat, Çifutët dhe të Krishterët kundër Muslimanëve, atëherë ai konsiderohet qafir dhe vepra e tij është kufër, ngase të ndihmohet Mushrikët kundër Muslimanëve është argument i miqësisimit të tyre në vend të Muslimanëve, dhe miqësimi është argument i dashurisë për fenë e tyre të kufrit dhe tregon për pëlqimin e fesë së tyre mbi Fenë Islame. Dhe s’ka dyshim që ky është kufër i cili detyrimisht të nxjerr nga Islami, Allahu na ruajt.

Mirëpo nuk është për qëllim me miqësimin e Mushrikëve dhe Qafirave bashkëpunimi me ta në gjëra të cilat janë të ndaluara, të cilat edhe Islami i ka ndaluar dhe i ka bërë haram. E për këtë çështje unë kam shkruajtur një fetva të cilën e kam sqaruar çështjen në detaj. Kjo për arsye se disa njerëz e konsideruan bashkëpunimin me popujt mosbesimtarë për ndalimin e terrorizmit të cilin e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij, pra e konsideruan atë bashkëpunim kufër dhe dalje nga Islami. Mirëpo e vërteta e cila është obligim që të ndiqet, është se nëse ndonjë grup nga qafirat na propozon që të bashkëpunojmë me ta dhe ata të bashkëpunojnë me ne në

<sup>29</sup> El-Ma`ideh, 51.

luftimin e diçkaje të cilën Islami e ka ndaluar dhe ka urdhëruar që të luftohet dhe të ndalohet, atëherë padyshim që ne e bëjmë këtë. Nëse neve na propozojnë që të bashkëpunojmë në ndalimin e imoralitetit (zinasë), për shembull, apo për të luftuar terrorizmin, për shembull, siç janë atentatet me bomba që po kryejnë disa Muslimanë me pretendimin se kjo gjë është ibadet; atëherë themi se ne bashkëpunojmë me ata tek kjo gjë.

Por, nëse na propozon ndonjë grup mosbesimtarësh që të luftojmë hixhabin të cilin e ka urdhëruar Allahu, apo mjekrrën që Allahu ka urdhëruar të lëshohet, apo për luftimin e çdo gjëje prej simboleve të Islamit, apo nëse ky grup na kërkon që të bashkëpunojmë me ta kundër Muslimanëve, atëherë në këtë rast s'ka pikë dyshimi se kjo është e ndaluar për ne. Madje, kush e bën këtë, bashkëpunon me ata dhe i ndihmon tek kjo gjë, atëherë ai konsiderohet si mik i kufarëve dhe përkrahësi tyre kundër Muslimanëve. Dhe kjo është prej llojeve të *riddes* (daljes nga Islami).



## ANULUESI I NËNTË:

**¶ nënti:** kush beson se disa njerëzve u lejohet të dalin nga Sheriati i Muhamedit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ashtu siç iu lejua Khidrit që të dilte nga Sheriatit të Musait (*'alejhis-selam*), atëherë ai është qafir.

### SHPJEGIMI:

Vërtet, Sheriati i Muhamedit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) është i përgjithshëm për të gjithë banorët e Tokës, njerëzit dhe xhinët. Ka thënë i Lartësuari:

قُلْ يَأَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ حَمِيْعًا

“Thuaj (o Muhamed): O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju.”<sup>30</sup>

Dhe ka thënë Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*): “Më janë dhënë pesë gjëra të cilat nuk ia janë dhënë askujt tjetër para meje; dhe prej tyre: Më përpara pejgamberi dërgohej vetëm për popullin e tij, ndërsa unë u dërgova për mbarë njerëzimin.”<sup>31</sup>

Ndoshta disa injorantë besojnë se është e lejuar të dalësh nga Sheriati i Muhamedit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) sikurse ndodhi me Khidrin që kishte dalë nga Sheriati i Musait (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Porse kjo tregon për injorancën e tyre rreth dërgimit të Muhamedit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) për mbarë njerëzimin dhe Sheriatin gjithëpërfshirës të tij, dhe se askush nuk mund të dalë nga prej tij, kurrë.

Dhe kush e ndoqi atë dhe pranoi shpalljen me të cilin erdhi ai, shpëtoi; dhe kush pretendoi se është i lirë që të dalë nga Sheriati i tij dhe pretendoi

<sup>30</sup> El-A'raf, 158.

<sup>31</sup> Transmetuar nga Bukhari (n.330) dhe Muslimi (n.521).

se atij i lejohet të dalë nga Sheriati i tij, ashtu siç pretendojnë disa Sufistë ekstrëmistë, atëherë me të vërtetë kjo gjë konsiderohet kufër dhe dalje nga Sheriati i tij, lavdërimet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.



## ANULUESI I DHJETË:

**Q dhjeti:** T'i kthesh shpinën Fesë së Allahut të Lartësuar duke mos e mësuar dhe duke mos e zbatuar atë. Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ۖ ثُمَّ أَعْرَضَ عَنْهَا ۚ إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ مُنْتَقِمُونَ ﴿٢٢﴾

“Kush është më zullumqar se ai të cilit kur i përmenden shpalljet e Zotit të tij nuk ua vëshin atyre? Vërtet, Ne do të hakmerremi ndaj kriminelëve!”<sup>32</sup>

### SHPJEGIMI:

Me të vërtetë, t'i kthesh shpinën Fesë së Allahut, të mos e mësosh e të mos e zbatosh atë, madje edhe kur të flasin për Islamin, siç është braktisja e shehadetit [La ilahe il-Allah], të mos e shqiptosh me gjuhë e të mos e mësosh kuptimin e tij dhe anuluesit e tij; dhe kur të thërrasin të mësosh kuptimin e fjalës La ilahe il-Allah që të mos biesh në ato gjëra që e kundërshtojnë atë, refuzon, i kthen shpinën dhe bëhet kryeneç; e megjithatë ai ka rënë në anuluesit e shehadetit, siç është adhurimi i njerëzve të mirë, shkuarja tek magjistarët dhe fallxhorët, të bërit tauaf në varre, të zotuarit në të vdekurit, të mos falurit e namazit që ka urdhëruar Allahu, ndërkohë që namazi është shtyllë e Islamit, pra kjo është braktisje e bazave të Fesë. Dhe robi nuk mund të jetë Musliman nëse nuk i pranon, nuk i ndjek, nuk i mëson dhe nuk i zbaton ato. Kështu që, kush i kthen shpinën këtyre bazave dhe parimeve dhe refuzon t'i pranojë, refuzon t'i mësojë dhe refuzon t'i zbatojë, atëherë ai është qafir me kufrin e braktisjes.

Dhe kufri ndahet në katër lloje:

---

<sup>32</sup> Es-Sexhdeh, 22.

- *Kufr el-I'raad* - Kufri i braktisjes;
- *Kufr et-Tekdhiib* - Kufri i mohimit, siç ishte kufri i mosbesimtarëve Kurejshë;
- *Kufr el-Inaad* - Kufri i kryeneçesisë, siç ishte kufri i Iblisit;
- [*Kufr el-Xhubud*] Kufri i Faraonit dhe popullit të tij; ka thënë i Lartësuar:

وَجَحَدُوا بِهَا وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنفُسُهُمْ ظُلْمًا وَعُلُوًّا

“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me kryelartësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta.”<sup>33</sup>

- Kufri i të bërit Shirk Allahut, që robi të besojë se Allahu ka ortak , ose të besojë se njerëzit e mirë gëzojnë njëfarë pozite tek Allahu, prandaj i marrin ata si ndërmjetësa dhe i adhurojnë për këtë arsye.
- Ndërsa *Nifaku* (hipokrizia) në besim mund të llogaritet si lloj i pestë dhe mund të thuhet: ai hyn në kufrin e mohimin (*Kufr et-Tekdhiib*), mirëpo munafikët shfaqin pohimin e besimin dhe e fshehin mohimin e tij.

Prej atyre që kanë përmendur katër lloje të kufrin janë: Es-San'anij në *el-Uddeh* dhe Shejkh Hafidh el-Hakemi në poezinë e tij kuptimplotë, të çmuar dhe unike.

Kurse Shejkhul-Islam Muhamed Ibn ‘Abdul-Uehab ka përmendur pesë lloje. Mirëpo lloji i pestë mund të hyjë tek kufri i mohimit (*Kufr et-Tekdhiib*), siç e thashë më parë. Kjo është ajo që shoh unë.



<sup>33</sup> En-Neml, 14.

## PËRFUNDIM:

Tha Shejkhul-Islam Muhamed Ibn ‘Abdul-Uehab *rahimehullah*:

“Nuk ka dallim tek të gjithë këta anulues të Islamit midis atij që i bën me shaka, atij që i bën me seriozitet dhe atij që e bën nga frika, me përjashtim të atij që është i detyruar me forcë. Të gjithë këta anulues përmbajnë rrezikun më të madh dhe ndodhin më së shumti, kështu që Muslimani duhet të ketë kujdes dhe të frikësohet mos bie në to. Allahu na ruajt nga to gjëra që sjellin Zemërimin dhe Ndëshkimin e Tij të dhimbshëm. Lavdërimi dhe bekimi i Allahut qoftë për më të mirin e krijesave të Tij, Muhamedin (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*), si dhe për Familjen dhe Shokët e tij.”

## SHpjegimi:

Ky është fundi me të cilin ai – Allahu e mëshiroftë – këshilloi Muslimanin që të ruhet mos bie në ndonjë prej këtyre anuluesve të Islamit, duke e thënë apo vepruar atë me seriozitet ose me shaka. Madje ai që thotë ndonjë prej këtyre anuluesve për t’u tallur, ky veprim i tij tregon nënçmin të Sheriatit dhe guximin (e tij) për të thënë fjalë që e hedhin poshtë Sheriatin. Prandaj nuk i lejohet Muslimanit që të thotë fjalë të cilat janë shirk duke u talluar, apo të tallet me diçka nga Feja e të Dërguarit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*), me shpërblimin apo me dënimin e Fesë së tij për shembull. E gjëta gjë është edhe me të gjithë anuluesit e tjerë: nuk i lejohet askujt që ta nënçmojë këtë dhe të bëjë diçka të tillë. Me të vërtetë kjo është njësoj si “Të luash më zjarrin”, për shkak se kjo gjë kanos rrezik të hatashëm dhe përbën krim dhe gjynah shumë të madh. Prandaj ruhuni, ruhuni!

Ndërsa ai që detyrohet me forcë, për të ka ardhur një ajet në Librin e Allahut, atëherë kur ‘Ammar Ibn Jasir ishte duke u torturuar dhe mushrikët nuk rreshtën së torturuari derisa ai lavdëroi idhujt e tyre. Pastaj

ai shkoi tek Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe Sahabët thanë: “Ammari bëri kufër.” Atëherë tha Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*): “*Ammari nuk bëri kufër, me të vërtetë Ammari është i mbushur me Iman që nga maja e këmbës e deri në palcë.*” Kështu, Allahu i Lavdishëm e i Lartmadhërishëm zbriti ajetin në suren en-Nahl:

إِلَّا مَنْ أَكْرَهَ وَقَلْبُهُ مُطْمَئِنٌّ بِالْإِيمَانِ

“...përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim.”<sup>34</sup>

Dhe thënia e Shejkhut (Muhamed Ibn ‘Abdul-Uehab), “dhe atij që e bën nga frika” do të thotë se nuk i lejohet atij që ka thjesht frikë që të bëjë ndonjë prej këtyre anuluesve dhe as nuk konsiderohet detyrim me forcë, përveç nëse ai e ndien se do ta dënojnë ose rrezikoni, si dhe situata të tjera të ngjashme.

Mirëpo këtu është një çështje tek e cila duhet patur kujdes, e cila është: a është justifikim detyrimi me forcë për fjalën dhe për veprën apo është vetëm për fjalën?

Kjo varet nga këndvështrimi; Ammar Ibn Jasir nuk u bëri sexhde idhujve të tyre, as nuk bëri tauaf rreth tyre, as nuk preu kurban për ta, porse tha me gjuhën e tij disa fjalë. Atëherë, a është vepra e njëjtë me fjalën?

Atij që i kërkojnë që të të bjerë në sexhde para një idhulli, ose që të bëjë ndonjë prej veprave që konsiderohen shirk i madh, a i lejohet atij ta bëjë një gjë të tillë duke iu referuar veprës së Ammarit, për të cilin zbriti ajeti?

Me të vërtetë vepra që bëri Ammari ishte veçse me fjalë, dhe hadithit: “*Ka hyrë në Xhenet një njeri për shkak të një mize, dhe ka hyrë në Zjarr një njeri tjetër për shkak të një mize.*”<sup>35</sup>

<sup>34</sup> En-Nahl, 106.

<sup>35</sup> Transmetuar nga Ahmedi në *ex-Zuhd* (fq.15-16) dhe Ebu Nu’ajmi në *el-Hiljeh* (1/203) me zinxhir të shkëputur (*meukuf*) që arrin deri tek Selman el-Farisij (*radij-Allahu ‘anhu*). Hadithi është shpallur i dobët nga el-Albani në *es-Silsiletu ed-Da’ifeh* (n.5829).



Nëse ky hadith është i saktë, atëherë ai është ndarës midis fjalës dhe veprës, pasi njeriu i cili ofroi kurban një mizë (për idhujt e atij populli) pretendoi se ishte i detyruar me forcë dhe besoi se ajo që bëri ishte e lejuar. Por nëse ai besoi se ajo që bëri ishte e lejuar, atëherë ai hyri në Zjarr për shkak të besimit të tij, edhe nëqoftëse ishte i detyruar me forcë, ngase çdo gjë që Muslimani ia ofron dikujt tjetër në vend të Allahut – edhe në qoftë e vogël siç është miza, apo qoftë e madhe siç është deveja – ai konsiderohet i dalë nga Islami me veprim dhe meriton Zjarrin, ngase vërtetë detyrimi me forcë ndodh me fjalë e jo me vepra.

Dhe sukcesi vjen vetëm prej Allahut.

Lavdërimi dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë Muhamed, si dhe mbi Familjen dhe Shokët e tij.



Përktheu: Alban Malaj  
27 Ramadan 1432/27 Gusht 2011  
'Auali, Mekkeh